



**UNIVERSITETI I MITROVICËS**  
**UNIVERSITY OF MITROVICA**  
**"ISA BOLETINI"**

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës  
http://www.umib.net; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues  
Dr. sc. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 1539  
Dt 02.12.2016

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 2.12.2016, mori:

**VENDIM**

- I. Për kompensimin e obligimeve financiare për:
  - profesorët, të cilët kanë qenë mentor ose anëtar të komisioneve për temat në nivelin bachelor, master dhe doktoratë, për vitin 2014, dhe
  - profesorët, të cilët janë avancuar në grada akademike, por që nuk kanë mundur të paguhen në bazë të Rregullores për të ardhura personale të UMIB-it, sepse kanë qenë në lista të pagave të UP-së, deri në momentin e kalimit në listë të pagave të UMIB-it. .
- II. Shuma e mjeteve të lejuara për ekzekutimin e këtij vendimi është:
  - 14,130.00 euro profesorët, të cilët kanë qenë mentor ose anëtar të komisioneve për temat në nivelin bachelor, master dhe doktoratë, për vitin 2014, në bazë të listave të paraqitura nga dekanët e njësive akademike, dhe
  - 18,479.51 euro për profesorët, të cilët janë avancuar në grada akademike.
- III. Këtij vendimi i bashkëngjitet lista e mentorëve dhe anëtarëve të komisioneve për diploma, të nënshkruara nga dekanët e njësive akademike, si dhe lista e emrave të profesorëve të avancuar, e nënshkruar nga prorektori për buxhet dhe financa..

**Arsyetim**

Këshilli Drejtues, pasi shqyrtoi kërkesat e dekanëve të njësive akademike të UMIB-it (FGJ dhe FTU) për pagesën e obligimeve financiare për profesorët, të cilët kanë qenë mentor ose anëtar të komisioneve për temat në nivelin bachelor dhe master, si dhe për një doktoratë, për vitin 2014, konstatoi se ky problem është krijuar për arsye se, profesorët e lartcekur gjatë asaj periudhe kohore kanë qenë në listën e pagave të UP-së dhe nuk kanë mundur të paguhen nga UMIB, përkundër insistimeve të menaxhmentit të Universitetit.

Gjithashtu, duke pasur parasysh kërkesat e vazhdueshme të profesorëve të UMIB-it, të cilët gjatë periudhës sa kanë qenë në lista të pagave me UP-në janë avancuar në grada akademike nga Senati i UMIB-it, Këshilli Drejtues ka konstatuar se kërkesa e tyre është e drejtë, pasi ata janë kompensuar në bazë të gradës akademike që kanë pasur, andaj është e arsyeshme që atyre t'u lejohet kompensimi i diferencës së pagës në bazë të gradës akademike.

Bazuar në këtë që u tha më lartë, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim i dorëzohet:

1. Arkivit të UMIB-it,
2. Menaxhmentit të UMIB-it,
3. Drejtorit për buxhet dhe financiar të UMIB-it,
4. Zyrtarit ligjor



Dr. sc. Sabri Sadiku

Kryesues i Këshillit Drejtues